



Garë për skenar 2008 - Ikje

TË MERRNI PJESË?

KUSH MUND TË MERR PJESË?

Mund të merrni pjesë nëse jeni 18 deri 28 vjeç, duke filluar prej dates 15 Prill deri më 31 Korrik 2008, dhe nëse jetoni në :Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Finlandë, Francë, Gjermani, Çeki, Hungari, Holandë, Itali, Kosovë, Maqedoni, Poloni, Rumani, Rusi, Spanjë, Suedi, e Turqi.

PËR ÇKA DUHET TË BËHET FJALË NË SKENAR?

Skenari duhet të jetë në masë të madhe në lidhje me temën e konkurimit: **Ikje**

SI DUHET TË DUKET SKENARI?

Skenari i juaj i shtypur nuk bënë të ketë më shumë se 20 000 shenja (duke përfshirë edhe shenjat e pikësimit). Skenari juaj mund të shkruhet në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare prej nga vini (*shih në rregullore*) Skenari i juaj duhet të jetë plotësisht origjinal, i shkruar nga ju personalisht (pa shkelje të drejtave autoriale). Duhet përcjellur rregullat elementare për të shkruar skenar (vetëm përshkrimi vizual, informacioni i dialogëve...).

SI TË KYÇEMI NË GARË?

Filloni menjëherë dhe regjistrohuni në on-line. www.nisimasa.com/

- Dorëzoheni regjistrimin e juaj dhe klikoni në pullën “Regjistrimi”.

- Shtypeni fletë regjistrimin e juaj prej kësaj ueb faqeje

- I dërgoni tre dokumentet e poshtë shënuera në zyrën e NISI MASA-s në shtetin tuaj (Asociacioni "7 arte" email adresa: shtatearte@yahoo.com , apo në adresën: rr.Bedri Gjinaj nr:1 Mitrovicë, 40000 Kosovë), para 31 korrikut 2008:

* aplikacionin e juaj të shtypur

* 1 kopje të skenarit tuaj (të shtypur, bashkangjitur me titull të shkruar, me emrin e juaj dhe adresën në faqe të parë)

* kopjen e skenarit në RTF format (rich text format) nëpërmes e-mailit për grupin nacional NISI MASA

Gjithashtu, mund të dërgoni sqarime në më së shumti një faqe, në të cilën i shpjegoni arsyet e pjesëmarrjes në gara dhe në cilën mënyrë skenari i juaj ka të bëjë me temën “Ikje”.

SI DO TË BËHET SELEKSIONIMI?

Seleksionimi është plotësisht i organizuar dhe zbatohet nga të rinjtë e Evropës, siç jeni ju, së pari, skenari juaj do të lexohet nga organizatori i garave në shtetin tuaj. Ata, në mes të skenarëve të arritura do ti zgjedhin dy skenarë (të zgjedhur nga juria) të cilat do të përkthehen në gjuhën Angleze dhe do tu shpërndahen organizatorëve në shtete tjera. Delegacioni i pjesëtarëve NISI MASA në Evropë do të takohen në Nëntor që t'i rishqyrtojnë skenarët e zgjedhura. Juria do ti përzgjedh tre skenarët më të mirë dhe do ta shpërndan shpërblimin “Ikje 2008”.

Skenaristët më fatlum do të kontaktohen gjatë Nëntorit 2008. dhe me ndihmën e rrjetit NISI MASA, skenarët do të shkojnë në produksion, ndërsa ata që hynë në mesin e 10 më të mirëve , fitojnë të drejtën të marrin pjesë në punorinë për shkruarje-skenari që mbahet në Francë.